



UNMIK/URDh/2002/21
1 tetor 2002

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2002/21

**ZBATIMI I RREGULLORES NR. 2000/2 TË UNMIK-UT, TË NDRYSHUAR, MBI
TAKSËN E AKCIZAVE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë me Nenin 6 të Rregullores nr. 2002/2 të Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 22 janar 2002, të ndryshuar, për taksat e akcizave në Kosovë

Duke marrë parasysh Kornizën Kushtetuese për Vetë-Qeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja Nr. 2001/9 e UNMIK-ut e 15 majit 2001),

Duke vepruar me kërkesën e Qeverisë dhe pas këshillimit me Këshillin Ekonomik dhe Fiskal në pajtim me nenin 8.1 (c) të Kornizës Kushtetuese për Vetë-Qeverisjen e Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të lirimit nga taksat e akcizave të importeve ose të qarkullimeve brenda RFJ-së në Kosovë të naftës për ngrohje (mazutit) që përdoret për ngrohje dhe qëllime prodhuese,

Shpall këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1
Lirimi

Importet apo qarkullimet brenda RFJ-së të naftës për ngrohje (mazutit) i cili përdoret nga ngrohtoret e qarkut për ngrohje dhe nga personat/entitetet për qëllime prodhuese, në varësi të procedurës së miratuar për kthimin e të hollave të paguara si taksë, lirohen nga pagesa e taksës së akcizave.

Taksa e akcizave e paguar për import apo qarkullim brenda RFJ-së të naftës për ngrohje (mazutit) në Kosovë kthehet në pajtim me Nenin 2.

Neni 2
Kthimi i të hollave të taksës së akcizave

2.1 Kthimi i parë i të hollave të paguara për akciza në naftë për ngrohje (mazut) në pajtim me këtë Urdhëresë administrative mbulon periudhën e një (1) muaji dhe bazohet në miratimin e aplikimit për kthim të të hollave të shoqëruar me dokumente relevante. Pas kësaj, periudha e aplikimit mbulon dy (2) muaj dhe kthimi i mëtutjeshëm bazohet në miratimin e aplikimit për kthim të të hollave të shoqëruar me dokumente relevante që pason pas një kontrolli të kryer nga Shërbimi i Doganave të UNMIK-ut. Ky kontroll përcakton sasinë e naftës për ngrohje (mazutit) të cilën e kanë përdorë aplikuesit për prodhim apo ngrohje gjatë periudhës relevante të aplikimit për kthim të parave.

2.2 Autoriteti Qendror Fiskal do të lëshoj një udhëzim administrativ i cili i përcakton procedurat e zbatimit të kthimit të parave të taksës së akcizave.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi me 1 tetor 2002.

Michael Steiner
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm